



Nr. 1170 prot.

Tiranë, më 14/07/2017

**Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik**

**Tiranë**

**Lënda:** Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1(një) vënd të lirë pune për punonjës administrate si më poshtë:

**Rektorati i Universitetit të Arteve:**

- **Administrator i Universitetit të Arteve**

**I.** Kandidati për pozicionin e lirë të punës **Administrator i Universitetit të Arteve** duhet të plotësojë këto:

**> KRITERE KUALIFIKUESE**

- 1.1 Të ketë kryer arsimin e lartë në fushën e Drejtësisë ose Ekonomisë së paku në nivelin "Master i Shkencave" (ose diplomë e integruar sipas ligjit të 80/205). Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar nga MAS;
- 1.2 Të ketë përvojë pune së paku 7 vjet në këto fusha;
- 1.3 Të mos ketë lidhje apo konflikt interesi me drejtuesit e Universitetit, Bordit të Administrimit dhe Drejtuesit e MAS;
- 1.4 Të ketë trajnime, kualifikime të ndryshme në fushën e menaxhimit ose administrimit në arsim;
- 1.5 Të ketë vlerësime pozitive nga punëdhënësit e mëparshëm;
- 1.6 Të zotërojë gjuhë të huaj (preferohet anglisht) nga fakulteti i Gjuhëve të Huaja ose nga Provime ndërkombëtare,
- 1.7 Të paraqesë një platformë zhvillimi për administrimin ekonomik dhe financiar të Universtetit;



**Shënim:** në rast se kandidatët konkurrentë nuk plotësojnë Kriteret Kualifikuese që parashikohen në Ligjin e Arsimit të Lartë (80/2015), nga të cilat pika 1.1 – 1.4 janë kritere bazë, kurse kriteret nga pika 1.5 – 1.7 janë kritere preferenciale.

**Mosplotësimi i kriterëve bazë 1.1 – 1.4 përbën shkak për skualifikimin e kandidaturave që do ti përcillen Bordit të Administrimit nga Senati Akademik.**

#### ➤ DOKUMENTACIONI I DOMOSDOSHËM

**Konkurrentët duhet të dorëzojnë në dosjet e tyre dokumentacionin sa më poshtë vijon:**

1. Letër motivimi për pozicionin e punës, për të cilin konkurren;
2. Dokumentin e identifikimit (fotokopje e noterizuar);
3. Jetëshkrimi (CV) në formatin Europass, shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
4. Diplomë shoqëruar me listë notash (e noterizuar) që vërteton kryerjen e arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit njehsimi nga MAS);
5. Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
6. Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me drejtuesit e Universitetit, Bordit të Administrimit dhe Drejtuesit e MAS;
7. Librezën e punës që vërteton përvojën e punës (fotokopje e noterizuar);
8. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim;
9. Të plotësojë Formularin e vetëdeklarimit në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
10. Çertifikatë/Diplomë trajnimesh ose kualifikimesh pasuniversitare në fushën përkatëse (nëse ka), të noterizuara;
11. Dëshmi e gjuhëve të huaja (nëse ka) nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ose nga provime ndërkombëtare (e noterizuar);
12. Çdo gjë që deklarihet në CV të jetë e dokumentuar dhe e noterizuar.

#### ➤ INTERVISTA ME GOJË

Intervista me gojë konsiston kryesisht në përgjigjet e pyetjeve rreth legjislacionit të Arsimit të Lartë, Legjislacionit për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor, Legjislacionin e



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

Prokurimeve Publike, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës në RSH, Legjislacionin për Rregullat e Etikës në Adm instratën Publike.

➤ **PROÇEDURA E PËRZGJEDHJES**

1. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret kualifikuese Miratohen nga Senati Akademik dhe i kalon Bordit të Administrimit;
2. Bordi i Administrimit shqyrton dosjen e secilit kandidat dhe vlerëson me 70 % të pikëve totale;
3. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve lidhur me zbatimin e detyrave si Administrator i UART, do të kryhet nëpërmjet intervistës me gojë, e cila do të përmbajë pyetje të strukturuar nga çdo anëtar i Bordit të Administrimit. Ky vlerësim do të llogaritet me 30 % të pikëve totale. Pikët totale të vlerësimit janë 100 pikë. Kandidati që shpallet fitues duhet të marrë mbi 50 pikë.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e menaxhimit të Burimeve Njërëzore në UART, duke filluar nga data **17.07.2017** deri më datë **28.07.2017** ora **14.00**.

Për datën e konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njërëzore në Rektoratin e Universitetit të Arteve, çdo ditë nga ora **08.00** deri në orën **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI  
  
REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE

